Takimi i 21-të koordinues i projektit Erasmus+ SINCERE

Më 17 nëntor 2026 u zhvillua takimi i 21-të koordinues online i projektit Erasmus+ **SINCERE – "Strengthening Integrity and Ethical Culture in Regional Higher Education"**, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të institucioneve partnere të konsorciumit.

Në fokus të takimit ishte raportimi i përmbledhur nga partnerët që kanë përfunduar organizimin e workshopeve informuese dhe konsultuese mbi draftin e Kornizës së Integritetit Akademik, në kuadër të Paketës së Dytë të Punës (WP2), Detyra 2.3 (T2.3).

Gjatë raportimeve u evidentuan mënyra e organizimit të workshopeve, përfshirja e grupeve të ndryshme të interesit, rezultatet e konsultimeve, sugjerimet e mbledhura dhe sfidat e mundshme në zbatimin e Kornizës.

Vëmendje e veçantë iu kushtua dokumentimit të këtyre veprimtarive, përshtatjes së Kornizës me kontekstin institucional të secilit universitet partner, hartimit të udhëzuesit për zbatimin e saj dhe planifikimit të procesit të miratimit nga senatet akademike.

Në vijim të takimit u diskutuan edhe çështjet e tjera të parashikuara në axhendë, që lidhen me hartimin e moduleve të trajnimit, përdorimin.



